



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Ref.Nr.01/45
02.08.2024

Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), nenin 15 të Ligjit Nr.08/L-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme, nenit 4 paragrafi 1. nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1.2. dhe nenit 7, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse, Shtojcën 12 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

1. Vendoset rregullimi i çmimeve dhe caktohen masat e tjera mbrojtëse për produktet e naftës të përdorshme në transport si vijon:

- 1.1. Marzha Tregtare maksimale e lejuar e shitjes me shumicë është dy (2) eurocentë për litër;
- 1.2. Marzha Tregtare maksimale e lejuar e shitjes me pakicë është dymbëdhjetë (12) eurocentë për litër;
- 1.3. Detyrohen subjektet për të furnizuar dhe për t'i ofruar për shitje produkte të naftës, si para vendosjes së çmimeve dhe masave mbrojtëse;
- 1.4. Mbikëqyrja e shtuar inspektuese;
- 1.5. Paraqitja e përshpejtuar e rastit te Autoriteti i Konkurrencës, kur ka dyshime për cenimin e konkurrencës së lirë;

2. Rregullimi i çmimeve dhe masat nga neni 1 i këtij Vendimi, mbeten në fuqi tridhjetë (30) ditë, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

3. Detyrohet Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe organet e tjera përgjegjëse të zbatojnë këtë Vendim.

ARSYETIM

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në veçanti Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut ka monitoruar rregullisht tregjet e produkteve të naftës dhe bazuar në evidencën ditore të pranuar nga Dogana e Kosovës lidhur me çmimet e furnizimit/importit të produkteve të naftës si dhe raportet e përditshme nga Inspektorati i Tregut lidhur me çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të naftës, megjithëse në tregun ndërkombëtar ka lëvizje të shpeshta të çmimeve, në tregun tonë të brendshëm këto lëvizje reflektohen kryesisht kur ka ngritje të çmimeve por jo edhe në rastet kur ka rënie të çmimeve. Prandaj, jo proporcionaliteti i çmimeve të naftës të deklaruar në import si dhe çmimeve në tregun tonë të brendshëm përbën bazë/shkas për rregullimin e çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse sipas nenit 15, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, nenit 3 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse.

Rregullimi i çmimeve dhe masave tjera mbrojtëse, caktohen në bazë të nenit 4 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse dhe ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit, për të mbrojtur konkurrencën dhe për të mënjeluar çrregullimet në treg.

Llogaritja e marzhës tregtare maksimale e lejuar për shitje me shumicë dhe pakicë bëhet sipas nenit 4 paragrafi 1.1 dhe 1.2. të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse. Duke u bazuar në atë që u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

4. Ky Vendim hynë në fuqi një (1) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Zyrës së Kryeministrit;
- Kabinetit të Ministres;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Doganës së Kosovës;

- *Inspektoratit të Tregut;*
- *Administratës Tatimore të Kosovës;*
- *Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit.*